# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443276**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbrojtja e Hashim Thaçit: Kundërshtojmë të gjitha transkriptet, fajësia nuk mund të mbështetet në to |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/mbrojtja-e-hashim-thacit-kundershtojme-te-gjitha-transkriptet-fajesia-nuk-i586043` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 13:41:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 14:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2e03ae701dd65dba16e45c4fc2240aaf51e557d037d7d0d9c808b87217874582` |
| TEKSTI | `4dddf7a4bb5d06352843d9a3925772734234a9384b9b56a71d3f36f3840539df` |
| PAMJA | `d95d06e6622dd72ba696e02a3ff0f9322c63deb21cac71844799738855e9f9ac` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2fe8035240fe948167b5f30f21a80c4ad6d591bf266d667f2fa68dc2c9c20838` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2fe8035240fe948167b5f30f21a80c4ad6d591bf266d667f2fa68dc2c9c20838`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Mbrojtja e Hashim Thaçit: Kundërshtojmë të gjitha transkriptet, fajësia nuk mund të mbështetet në to

TemA
14 Shtator 2026, 16:50Rajoni TEMA




Avokatja Sophie Menegon, e cila përfaqëson Hashim Thaçin në çështjen për administrimin e drejtësisë në Gjykatën Speciale, ka kundërshtuar përdorimin e transkripteve të Prokurorisë, duke argumentuar se ato nuk mund të shërbejnë si bazë për shpalljen fajtor të ish-presidentit të Kosovës.

Gjatë seancës, Menegon shpjegoi se mbrojtja ka kundërshtuar transkriptet në tërësi dhe jo vetëm pjesë të veçanta të tyre, pasi, sipas saj, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nuk e ka përmbushur barrën e provës.

“ZPS-ja nuk e ka përmbushur barrën e provës dhe privilegjin e kundërvetëinkriminimit”, deklaroi Menegon.

Sipas saj, i takon Prokurorisë të dëshmojë saktësinë dhe besueshmërinë e të gjitha provave që paraqiten para gjykatës.

“Ne kundërshtojmë transkriptet në tërësinë e tyre dhe nuk kundërshtojmë fjali të caktuara të transkripteve. Nuk pritet që tani mbrojtja të ketë barrën e provës ose të akuzuarit të kenë barrën e provës për të vërtetuar pasaktësinë”, tha avokatja.

Menegon argumentoi gjithashtu se transkriptet nuk duhet të pranohen si prova, përveç rasteve kur ato mbështeten nga ekzaminime shkencore dhe nga dëshmitarë të cilët kanë pasur mundësi t’i nënshtrohen kundërpyetjeve.

“Shpallja fajtor në këtë çështje nuk mund të bazohet vetëm në shkallë të gjerë në transkriptet e ZPS-së. Personat që i kanë bërë këto transkripte janë të panjohur dhe mbrojtja nuk e ka pasur mundësinë që t’i marrë në pyetje ata”, u shpreh Menegon.

Mbrojtja e Thaçit ka insistuar se çdo vendim i gjykatës duhet të mbështetet në prova të verifikueshme dhe jo në materiale për të cilat, sipas saj, nuk është dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme saktësia dhe besueshmëria.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[SHBA-ja paralajmëron Serbinë për afrimin me Kinën në fushën e IA-së]

14:20 Rajoni / 1 koment

[Verdikti që po mban Kosovën në ankth, çfarë presin qytetarët më 16 shtator]

12:20 Rajoni

Kosovë/ PDK çon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit, paralajmëron edhe kërkesë për Qeverinë Kurti 4

09:52 Rajoni / 1 koment

Kurti 4 pa urime: Këtë herë mungoi edhe Sali Berisha



22:50 Rajoni / 24 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.